

ALFIL WG

PRODUKT PER MBROJTËS E BIMËVE

GRUPI	P07	FUNGICID
--------------	------------	-----------------

ALFIL WG është një fungicid sistemik, me lëvizshmëri ngjitëse dhe zbritëse, me aktivitet thelbësisht parandalues që vepron duke stimuluar mbrojtjen fiziologjike të bimëve dhe me një veprim kurativ të drejtpërdrejtë mbi patogjenin.

Lënda vepruese: fosetyl-al 80%

Formulimi: Granula të shpërndara në ujë (WG)

ATTENTION



Deklaratat e rrezikut:

H412: E dëmshme për jetën ujore me efekte afatgjata.

H319: Shkakton acarim të rëndë të syve

Deklaratat paraprake:

P264: Lajeni me kujdes pas përdorimit.

P280 : Vishni doreza mbrojtëse/veshje mbrojtëse/mbrojtje për sytë/mbrojtje për fytyrën

P305+P351+P338: NËSE KA KONTAKT ME SYTË: Shpëlani me kujdes me ujë për disa minuta. Hiqni lentet e kontaktit, nëse janë të pranishme dhe është e lehtë për t'u bërë. Vazhdoni shpëlarjen

P273: Shmangni lëshimin në mjedis

P501: Hidhni përmbajtjen/enën në përputhje me rregulloret në fuqi.

MASAT E NDIHMËS SË PARË:

Nëse keni dyshime, ose nëse shqetësimet shëndetësore vazhdojnë, kërkoni ndihmë mjekësore. Asnjëherë mos administroni asgjë nga goja e një personi pa ndjenja.

Thithja: Vendoseni personin e dëmtuar në ajër të pastër, nëse frymëmarrja është e parregullt ose ndalet, kryeni frymëmarrje artificiale.

Kontakti me sy: Hiqni lentet e kontaktit, nëse janë në përdorim dhe të lehta për t'u hequr. Shpëlajeni sytë me ujë të pastër dhe të ftohtë dhe kërkoni kujdes mjekësor.

Kontakti me lëkurën: Hiqni rrobat e kontaminuara. Lani me sapun dhe ujë të bollshëm ose me një pastrues të sigurt lëkurën. Asnjëherë mos përdorni tretës ose hollues.

Gëlltitja: Në rast të gëlltitjes aksidentale dhe keni shqetësime, kërkoni kujdes mjekësor. Asnjëherë mos nxitni të vjella.

Perdorimi:

Aplikoni me spërkatje gjatë vegjetacionit në kultivat e mëposhtme:

Ne perime (trangull, bostanore, domate, spec, sallate, spinaq, qepe, etj.), per kontrollin e vrugjeve, me 0.2-0.25%. Kryhen deri 4 trajtime/sezoni.

Ne patate, per kontrollin e vrugut, me 0.2-0.25%.

Hardhi: Per kontrollin e vrugut (*Plasmopara viticola*), me 0.2-0.25% duke u kombinuar me fungicide kontakti.

Luleshtrydhe e bime zbukuruese: Per kontrollin e vrugut (*Phytophthora cactorum* e *Phytophthora fragaria*). Fidanët para mbjelljes zhyten në një solucion 0.25% per 15 minuta dhe pas mbjelljes bëhen 2-3 spërkatje me të njejtën dozë: një në vjeshtë dhe dy në pranverë. Kjo teknike trajtimi ndihmon mjaft ne shkatërrimin e parazitit ne tokat qe mund te jene te infektuara.

Sallatë: Per kontrollin e vrugut (*Bremia lactuca*), me 0.2-0.25%, duke perdorur te pakten 3 kg produkt per hektar.

Pemë frutore farore (mollë, dardhe): Per kontrollin e *Phytophthora cactorum*: trajtoni me spërkatje gjate vegjetacionit duke bërë nga një spërkatje çdo muaj, duke filluar pas lulëzimit e deri 40 dite para vjeljes, me 0.25%.

Ne bimet e dobesuara nga semundja me aparat gjethor te pa afte per te thithur fungicidin siç duhet, trajtohet trungru dhe qafa e bimes nje here ne muaj duke filluar pas lulezimit deri 40 dite para vjeljes. Per kete përgatitet nje paste duke perdorur 5 kg preparat, te tretur ne 100 lit uje dhe duke shpenzuar 1-2 lit/trung.

Agrume: Per kontrollin e gomozës parazitare (*Phytophthora spp.*), me 0.2-0.25%, duke perdorur 10 litra solucion/pemë.

Në raste kur bimët kanë vegjetacion të dobët për shkak të sëmundjeve, preparati merret nga gjethet me veshtiresi dhe qarkullimi ne lengjet bimore eshte i dobet, prandaj ne keto raste aplikohet edhe trajtimi i trungrut dhe degeve ne pjeset e infektuara.

Fidanishte pemësh: Për kontrollin e kalbëzimit të rrënjëve nga fitoftora (*Phytophthora spp.*), duke bërë nga nje spërkatje çdo muaj, me 0,25%.

Fitotoksiciteti:

Ne dozat dhe bimet e rekomanduara nuk shfaq shenja fitotoksiciteti.

Verejtje per perdorimin:

Trajtimet kryhen kur ka rrezik infeksioni ose duke u bazuar ne te dhenat qe jep prognoza.

Perdoren volume te medha tretesire sperkatese, per te siguruar lagie te mire te mases gjethore. Nuk është i pajtueshëm me vajra minerale dhe produkte me bazë bakri.

Në rast se janë përdorur vajra mineralë, duhet përdorur një javë më vonë.

Nuk është i pajtueshëm me plehrat gjethorë që përmbajnë azot mineral.

I pajtueshëm me PMB-te e tjera.

Ndikimi ne mjedis:

I dëmshëm për organizmat ujorë: mund të shkaktojë efekte afatgjata në mjedisin ujor.

Ky material dhe ambalazhet duhet të eliminohen në mënyrë të sigurtë.

Mos ndotni ujërat me produktin ose ambalazhet e tij. Mos pastroni pajisjet spërkatëse pranë ujërave sipërfaqësore. Evitoni ndotjen nëpërmjet rrjedhjes.

Karenca:

Agrume 15 ditë; Hardhi 28 ditë; Pemë frutore 14 ditë; Perime 4-7 ditë.

Magazinimi:

Ruhet ne vende te thata, te ajrosura, te erreta, ne ambalazhin origjinal.

Nr dhe data e regjistrimit: 571; datë 17.9.2014.

Sasia neto e PMB-se, që ndodhet në ambalazhin; deri 1 kg.

Data e prodhimit..... ;

Data e skadencës ose periudha e ruajtjes (sipas kërkeseva të përcaktuara): 3 vjet;

Numri i partise se mallit (serise) ose shenja te tjera identifikuese..... ;

Tipi i ambalazhit baze: Material i pa pershkueshem nga lageshtia.

Aplikanti: Albaugh LLC. **Adresa:** Grajski trg 21, 2327 Rače, Slovenia.

Prodhuesi: 1. Industrias Afrasa S.A. **Adresa:** Pol. Ind. Fuente del Jarro Paterna (Valencia) Spanjë.

2. March Chemicals Co. Ltd. **Adresa:** Zhejiang Xinan Chemical Industrial Group Co, Ltd, Xinan, Jiande, Zhejiang, 311600 Kinë.

Emri dhe adresa e ambalazhuesit (kur ambalazhimi kryhet ne Republiken e Shqiperise):